



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Conex” LLC të datës 26.08.2024 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Intervenime infrastrukturore - ndarja zonale në 6 zona në tërë territorin e Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-24-3595-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Conex” LLC të datës 26.08.2024 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Intervenime infrastrukturore - ndarja zonale në 6 zona në tërë territorin e Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-24-3595-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Conex” LLC (tutje “parashtruesi”) me datë 26.08.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Intervenime infrastrukturore - ndarja zonale në 6 zona në tërë territorin e Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-24-3595-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë se tenderuesit e rekomanduar për kontratë për lot 4, 5 dhe 6 kanë dorëzuar oferta të papërgjegjshme.

AK ka analizuar me kujdes të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit sikurse janë prezantuar në kërkesën për rishqyrtim, pa nevojën që të njejtat të përsëriten në këtë vendim. Me këtë rast janë analizuar me kujdes jo vetëm ofertat e tenderuesve të rekomanduar por edhe oferta e vet parashtruesit në raport me kërkesat e DT. Me këtë rast është gjetur se parashtruesi parimisht nuk është fare palë e interesuar pasi që nuk ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit. Me këtë rast duhet theksuar që komisioni vlerësues ka lëshuar një gabim teknik duke e cilësuar parashtruesin si tenderues të pasuksesshëm dhe jo si tenderues të papërgjegjshëm respektivisht të eliminuar.

Sidoqoftë, nga analizimi i ofertës së parashtruesit rezulton se i njëjti në planin dinamik që ka dorëzuar nuk e ka bashkangjitur fare pikën V të rekapitullimit që nënkupton se plani dinamik nuk është i kompletuar. Tutje, parashtruesi ka prezantuar si menaxher të projektit një person i cili është prezantuar si menaxher i projektit edhe për tenderuesin e rekomanduar për lotin 3 në këtë aktivitet të prokurimit. Tutje parashtruesi nuk ka dorëzuar as të gjitha çertifikatat ISO sikurse janë kërkuar me DT. Pra ekzistojnë disa kërkesa të dosjes së tenderit të cilat parashtruesi nuk ka arritur që t'i përmbushë dhe për këtë arsye oferta e të njëjtit është e papërgjegjshme. Nga ky këndvështrim, parashtruesi nuk është fare palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP pasi që nuk mund të dëshmojë asnjë interes material nga cilido epilog i aktivitetit të prokurimit në rast të rivlerësimit përderisa vet ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme.

Sidoqoftë, AK ka analizuar me kujdes edhe pretendimet ankimore të parashtruesit kundër tenderuesve të rekomanduar për lotet 4, 5 dhe 6. Me këtë rast është gjetur se të gjithë tenderuesit e rekomanduar për lotet e kontestuara nga parashtruesi janë tenderues tërësisht të përgjegjshëm dhe janë rekomanduar për kontratë në përputhje të plotë jo vetëm me kriteret e dhënies së kontratës por edhe me kërkesat e dosjes së tenderit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 28.08.2024

Visar SHEHU



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.